

URDHËR
Nr. 275, datë 14.6.2022

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË REGJISTRIT TË PËRDORIMIT TË PRODUKTEVE
PËR MBROJTJEN E BIMËVE NË FERMË, PËRMBAJTJES DHE PLOTËSIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të pikës 10, të kreut V, të vendimit nr. 317, datë 9.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve, si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të regjistrit të përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në fermë, përmbajtjes dhe plotësimit të tij, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri.
 2. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve mban të dhënat për fermerët e pajisur me regjistrin e përdorimit të PMB-ve, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij urdhri.
 3. Plotësimi i regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë kryhet nga vetë prodhuesi.
 4. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor organizojnë fushata informimi, trajnimi dhe asistencë për plotësimin e regjistrit nga fermerët.
 5. Prodhimi, shpërndarja dhe kontrolli i mbajtjes së regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë kryhet nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
 6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA 1
MODELI I REGJISTRIT TË PËRDORIMIT TË PMB-ve NË FERMË, PËRMBAJTJA DHE
PLOTËSIMI I TIJ



Numri i serisë: _____

Data e dorëzimit të fermerit: _____

**REGJISTRI I PËRDORIMIT TË PRODUKTEVE PËR
MBROJTJEN E BIMËVE (PMB) NË FERMË**



PLOTËSIMI I REGJISTRIT TË PËRDORIMIT TË PMB-ve NË FERMË

Për plotësimin e të dhënave të regjistrit, referojuni sqarimeve të mëposhtme:

“Bimë” është kultura bujqësore ku është kryer trajtimi me PMB. Për kulturat që mbillen më shumë se një herë, do të shënohet kultura I dhe në vazhdim kultura II (p.sh.: Domate I/Domate II).

“Sipërfaqja totale (dynym)” është sipërfaqja totale e fermës.

“Numri i trajtimit” është numri rendor i spërkatjes që kryhet, me rend ngjites.

“Arsyeja e përdorimit/dëmtuesi” është emri i dëmtuesit ose shkakut për të cilën është përdorur PMB-ja.

“Faza fenologjike e bimës” është stadi i zhvillimit në të cilën ndodhet bima në momentin e trajtimit.

“Emri tregtar i PMB-së dhe i lëndës/ve vepruese” është emri tregtar i PMB-së së përdorur, si dhe i lëndës/ve vepruese në përmbajtje të saj,

“Blerë nga” është subjekti i tregtimit me pakicë, ku është blerë PMB-ja, shoqëruar me faturë blerje.

“Faturë blerje” është dokumenti i shitjes nga subjekti i tregtimit me pakicë, sipas legjislacionit fiskal.

“Sipërfaqe e trajtuar (dynym)” është sipërfaqja ku kryhet trajtimi.

“Doza e përdorur” është sasia (gr ose ml) për dynym ose përqendrimi në përqindje i PMB-së dhe sasia e solucionit të përdorur për dynym, që është përdorur faktikisht.

“Data e trajtimit” është data kur kryhet trajtimi me PMB.

“Karenca” është intervali kohor, i shprehur në ditë, ndërmjet trajtimit të fundit dhe vjeljes, ndërsa për produktet e magazinuara ndërmjet trajtimit të fundit dhe hedhjes në treg.

Të dhënat për produktin:

- **“Data e vjeljes”** është data e vjeljes ose korrijes së bimës apo produktit bimor, të trajtuar me PMB. Për bimët me mbi një vjelje, shënohet data e çdo vjelje të kryer.

- **“Shitur tek”** është emri i personit ose subjektit, që i është shitur produkti bimor i trajtuar; si dhe

- **“Sasia (kg)”** është sasia që shitet pas çdo vjelje.

Shënime. Nënkupton pasqyrimin e çdo problematike të ndodhur gjatë përdorimit të PMB-ve në fermë dhe rreth saj.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri dhe mbiemri i fermerit/subjektit: _____

Kodi i fermës/NIPT/NUIS: _____

Bashkia: _____

Njësia Administrative: _____

Fshati: _____

Pronësia/përdorimi i tokës bujqësore: _____

(AMTP/certifikatë pronësie/qira/përdorim)

Zona kadastrale nr. _____

Parcela 1, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 2, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 3, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 4, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 5, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 6, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 7, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë;

Parcela 8, nr. kadastral/pasurisë: _____, sipërfaqja: _____ dynymë.

